



## AKT - THEMELIMI

### SHOQERISE NDERTIMORE-TREGTARE " BOGDANI", Sh.p.k.

E lidhur sot me date 6.4.1994, nga une ortak i vetem Agim Sh. i biri i Mehmetit dhe i Fatimes, i datlindjes 1947, lindur e banues ne Kukes, L.I, apartamenti 21.

#### Neni 1

Krijohet nji shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin " BOGDANI", Sh.p.k.

#### Neni 2

Objekti i shoqerise eshte : Projekttime, ndertime, tregetim te materialeve te ndertimit e te mallrave te ndryshme si industriale, veshmbathje etj., me shumice dhe pakice, Import-Eksport etj.

#### Neni 3

Selia ligjore e administrative e shoqerise nodhet ne Kukes, Lagja 1, apartamenti 21. ajo mund te hape edhe agjensi e filiale te tjera ne Tirane, Durres dhe Elbasan, MAS

#### Neni 4

Periudha e veprimtarise se shoqerise eshte mbi 15 vjet dhe mund te zgjase me vendim te ortakut te vetem.

#### Neni 5

Shoqeria eshte formuar ne perputhje me dispozitat e legjislativionit Shqiptar dhe do te veproje ne perputhje me aktin themelor dhe statutin e bashkengjitur.

#### Neni 6

Kapiteli themeltar i shoqerise eshte 500 (peseqind)mije leke dhe eshte derdhur ne kohen e krijimit te firmes ne organet perkatese.

#### Neni 7

Shoqeria ka te drejte qe ne perberjen e saj te pranoje edhe bashkepuntore te jashtem pas miratimit te ortakut te vetem me nji shprehje erblim te vendosur nga ai vete.

#### Neni 8


Seicili ortak pergjigjet vete per pasojat ose demet qe mund te shkaktojne shqerime me veprimet e tij me faj. Ortaku i vetem ka te drejte te prishi shoqerine sipas rregullave perkatese.

#### Neni 9

Te gjitha mosmireveshjet qe nuk zgjidhen me bisedime, zgjidhen ne rruge gjyqesore.

#### Neni 10

Shpenzimet qe behen per qellime te fitimit te shoqerise evidencohen ne librin perkates dhe kur behen disa ortak ndahen proporcionalisht.



light midis ortakeve nga nji ortak i caktuar administrator i shoqerise.

Neni 11

Kjo kontrate (akt-themelimi), perpilohet ne 4 kopje ne gjuhet shqipe dhe pasi lexohet nenshkruhet rregullisht.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE NDERTIMORE-TREGTARE  
" BOGDANI ", Sh.p.k.

AGIM SHEHU



Tirane, me 6.4.1994

# STATUTI

## I SHOQERISE "BOGDANI", Sh.p.k.



### Neni 1

#### Formimi

Ne baze te aktit te themelimit date 6.4.1994 eshte krijuar Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar ndertimore e tregtare "BOGDANI", Sh.p.k., me ortak te vetem Agim Shehun, i biri i Mehmetit dhe i Fatimese, i datlindjes 1947, lindur e banues ne Kukes, L.1, apartamenti 21.

### Neni 2

#### Selia

Selia ligjore e administrative e shoqerise ndodhet ne Kukes, lagja 1, apartamenti 21. ajo mund te hape agjensi e filiale ne Tirane, Durres dhe Elbasan, HAS

### Neni 3

#### Koha - zgjatja

Shoqeria ka nji koha zgjatje te veprimtarise ekonomike mbi 10 vjet dhe mund te zgjase ate me vendim te ortakut te vetem ose unanimisht te ortakëve ne rast se do te shtohen ortakët. Shoqeria mund te ndryshoje vend qendrim dhe objektin e veprimtarise sipas vendimeve qe do merr ortakut i vetem.

### Neni 4

#### Objekti

Objekti i shoqerise eshte : Projekttime, ndertime, tregetim te materialeve te ndertimit e mallrave te ndryshme si industriale, veshmbardhje etj., me shumice dhe pakice, Eksport-Import.

### Neni 5

#### Kapitali i shoqerise

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 500 Peseqind mije leke. Kapitali i shoqerise mund te shtohet dhe paksohet me deshirime te ortakut te vetem.

### Neni 6

#### Organizimi dhe drejtimi i shoqerise

Shoqeria drejtohet nga ortakut i vetem i saj Administrator eshte Agim Shehu.

### Neni 7

Ortakut i vetem eshte i veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e shoqerise pa asnji lloj perjashtimi. Ai ka te drejte te permbushit gjitha aktet qe jane te pershtatshme per arritjen e qellimeve te shoqerise.

Ortakut i vetem ka te drejten e blerjes, shitjes, te japi me leshje perdorje pasuri te lufteshme e te palufteshme, te kembimit te pasurive.

*Atlehu*



te marri pjese ne shoqerite e tjera te formuara ose qe do formohen, t  
prizoje qdo lloj veprimi prane te gjitha zyrave publike e private  
gjidhi prane institucioneve bankare e financiare te gjitha veprimi  
me to. Vendos per hartimin e kontratave te punes, caktimin e pagav  
caktimin e qmimeve te blerjes e shitjes e tarifave te sherbimit, zgje  
min e veprimtarise sipas drejtimeve te caktuara ne kontrate.

Neni 8

Ortaku i vetem mund te emerroje nji ose me shume administrator  
duke percaktuar detyrat e pagesat e tyre. Ortaku i vetem mund te emer  
punonjes edhe per kujdestari te veqant. Ortaku i vetem mund te emerroj  
nji keshill administrativ qe do te kete fuqi vendimore.

Neni 9

Perfaqesimi i shoqerise

Shoqeria perfaqesohet me firmen e lire te ortakut te vetem, e  
administratoreve, por me vendim te ortakut te vetem. Administratorët jo  
ortak te emeruar prej ortakut te vetem kane kopetencen te sbatojne  
te gjitha vendimet dhe urdherat e tij, brenda kopetencave te caktuara  
per ta ne aktin e emerimit ose ne proces verbal te veqant. Ortaku i v  
dhe administratorët e emeruar prej tij kane kopetencen e perfaqesimi  
ne veprime dhe kerkese gjyqesore si dhe per gjykime, te emerojne, te  
anullojne dhe te pushojne avokat per qeshtje ne gjykim.

Neni 10

A s a m b l e a

Asamblea e zakonshme e thirrur nga ortakut i vetem behet me  
leter, korespondence (me pergjigje te paguar), derguar ortakeve ne bene  
te pakten 15 dite para thirrjes per mbledhje. Ne leter tregohen dita  
ora e mbledhjes, lista e materialeve qe do trajtohen. Ne te njejten lo  
do te jene treguar edhe vendi, dita e ora per mbledhjen e dyte, n.q.s.  
para nuk do zhvillohet per ndonji arsye. Qdo ortak ka te drejten te r  
pjese ne vendime dhe disponon nji numur votash te barabarta me pjese  
e kapitalit themelor qe ai disponon. Qdo ortak mund te perfaqesohet  
asamble me akt perfaqesimi te shkruajtur nga nji ortak tjeter. Asamb  
do te drejtohet nga ortakut me i vjeter, ne pamundesi nga personi i z  
dhur nga asamblea. Shoqeria mban librin e vendimeve te asamblese, te  
nzimeve, te ardhurave etj.

Neni 11

Mbi kontroll - revizionin

Ortaku i vetem mund te caktoj kontrolllore per veprimtarine  
ekonomike financiare te shoqerise. Pagesat per to caktohen nga vete  
ortaku i vetem. Kontrolloret, kontrollojne dhe verifikojne ne se veprime  
administratoreve zhvillohen ne perputhje me ligjen ne fuqi ose sipa

*Handwritten signature*



statutit te shoqerise.

### Neni 12

#### Bilanci dhe te ardhurat

Veprimet e shoqerise mund te mbyllen me 31 Dhjetor te qdo viti. Ne fund te qdo periudhe administratoret nxjerrin bilancin kontabel te shoqerise ose rezultatin ekonomik te fitimit apo humbjes sipas rregullave e ligjeve ne fuqi.

### Neni 13

Te ardhurat netto pas zbritjes se tatim fitimit dhe krijimit te fondeve te akumulimit, i mbeten ortakut te vetem si pasuri e tij.

### Neni 14

#### Marredheniet e punes

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per qeshtje qe nuk rregullohen me kontrate pune, zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit Shqiptar.

### Neni 15

Shoqeria merr persiper qe te respektoje rregullat ne fuqi te punsimit e te sigurimeve shoqerore per te gjitha te punesuarit ne shoqeri ndersa keta te fundit jane te detyruar te pranojne kete statut.

### Neni 16

Te punesuarit ne shoqeri pergjigjen sipas ligjit dhe sipas ketyre statutit per mos zbatimin e detyrave te ngarkuara dhe per demet e shkakuarara shoqerise. Administratori mbajne pergjegjesi civile e penale ne krah te erjen e detyrave te tyre. Te gjitha te punesuarit jane te detyruar te ruajne sekretin ne shoqeri. Detyra per ruajtjen e sekretit te punes nga te punesuarit vazhdon edhe mbas largimit te tyre nga puna ne shoqeri.

### Neni 17

#### Prishja

Prishja e shoqerise mund te behet ne qdo kohe dhe per qdo lloj shkak. Eshte ne kopetence te ortakut qe te percaktoje menyrat e likuidimit te shoqerise. Per kete qellim mund te caktoj nji ose me shume likuidator per te percaktuar aktivitetin e shoqerise.

### Neni 18

#### Dispozita te pergjithshme

Shoqeria vepron si person juridik qe nga dita e regjistrimit ne gjykaten e rrethit Tirane, ndersa ushtron aktivitetin ekonomik te saj te parashikuar ne nenin 4 te ketyre statutit, mbasi merret dhe sipas lejeve se ushtrimit te aktivitetit marre nga seksioni i tatimit perkates.

*Atalay*

Neni 19

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i refer ligjeve te tjera ne fuqi ne Shqiperi.

Neni 20

Ky statut u shtyp ne 4 kopje ne gjuhen shqipe e qe do te shperndahet ne organet kompetente, ndersa nji kopje mbetet si pjese e dokumentacionit baze te formimit te shoqerise.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE " BOGDANI", Sh.p.k.

AGIM SHEHU



Tirane, ne 6.4.1994